



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.7, datë 5.2.2007

**PËR  
MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT  
PËR FORMULARËT E STREHIMIT NË TIRANË**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit Nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", neni 30, neni 31, neni 35 dhe neni 36, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit për formularët e strehimit në Tiranë, si vijon:

- |   |        |
|---|--------|
| • Aplikanti është i ve ose i divorcuar  | 1 pikë |
| • Çdo familjar  | 1 pikë |
| • Statusi i veçantë (i verbër, jetim, invalid, etj)   | 2 pikë |
| • Familja banon me qera   | 2 pikë |
| • Banon në një objekt tjetër  | 1 pikë |
| • Banon në kushte të këqija higjieno-shëndetësore   | 2 pikë |
| • Banon në një banesë rrezik shembje  | 2 pikë |
| • Të ardhurat e famijes janë nga 0 deri në 10000 lekë në muaj   | 6 pikë |
| • Të ardhurat e famijes janë nga 10000 deri në 20000 lekë në muaj   | 4 pikë |
| • Të ardhurat e famijes janë nga 20000 deri në 30000 lekë në muaj   | 3 pikë |
| • Të ardhurat e famijes janë nga 30000 deri në 40000 lekë në muaj   | 2 pikë |
| • Të ardhurat e famijes janë mbi 50000 lekë në muaj   | 1 pikë |
| • Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk për zgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesit shoqëror | 1 pikë |
| • Çiftet e reja në moshë totale deri në 55 vjeç   | 1 pikë |

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**